



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Rendit Publik
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nr.3

Tel: 247155

Per shtetesine ne Republiken e Shqiperise

Cilat jane aktet ligjore e nenligjore per shtetesine shqiptare ne Republiken e Shqiperise ?

Aktet ligjore e nenligjore ne fuqi per shtetesine shiptare ne Republiken e Shqiperise jane :

- 1. Ligji nr. 8389, date 05.08.1998 "Per shtetesine shqiptare";**
 - 2. Ligji nr. 8442, date 21.01.1999 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 8389, date 05.08.1998 "Per shtetesine shqiptare".**
- Udhezimi i perbashket i Ministrit te Rendit Publik (nr. 925 date 03.03.1999), Ministrit te Puneve te Jashtme (nr.337/1 date 08.03.1999) , Ministrit te Drejtesise (nr.782/1 date 25.03.1999) dhe Ministrit te Financave (nr.583/3 date 05.03.1999) "Per procedurat qe ndiqen per fitimin e shtetesisë shqiptare me natyralizim";
 - Udhezimi i Ministrit te Rendit Publik (Nr. 3583 date 27.11.2001) dhe Ministrit te Puneve te Jashtme (nr. 6252 date 10.12.2001) "Per procedurat dhe dokumentacionin per fitimin, rifitimin dhe heqjen dore nga shtetesia shqiptare".

Cilat jane kushtet, qe duhet te plotesoje shtetasi shqiptar per te hequr dore nga shtetesia shqiptare ?

Shtetasi shqiptar ka te drejte te heqe dore nga shtetesia shqiptare vetem nese plotesohen njeri nga kushtet vijuese :

- te kete nje shtetesi tjetër ose
- te kete fituar nje shtetesi tjetër ose
- t'i jete garantuar dhenia e nje shtetësie tjetër nga organet kompetente te shtetit te huaj.

Te miturit fitojne dhe humbasin shtetësinë me miratimin e prindërve. Per minorenet e moshes 14-18 vjeç merret edhe pelqimi i tyre.

Cilat jane kushtet, qe duhet te plotesoje shtetasi i huaj per te fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim ?

Shtetasit te huaj i lind e drejta te per te kerkuar shtetësinë shqiptare me natyralizim kur ploteson kushtet vijuese :

1. Te kete mbushur moshen 18 vjeç. Llogaritja behet ne ditën e berjes se kerkeses;
2. Te kete banuar ligjerisht ne territorin e Republikes se Shqiperise, ne menyre te vazhdueshme, per jo me pak se 5 vjet;
3. Te kete banese dhe te disponoje te ardhura te mjaftueshme;
4. Te mos kete qene ndonjehere i denuar (ne Republiken e Shqiperise ose ne ndonje vend tjetër) per vepra penale, per te cilat ligji parashikon denime me jo me pak se 3 vjet heqje lirie. Perjashtim nga ky rregull behen ne rastet kur vleresohet se denimi eshte dhene per motive politike;
5. Te kete njohur , te pakten fillestare, te gjuhes shqipe;
6. Dhenia e shtetësisë shqiptare te mos preke sigurimin dhe mbrojtjen e Republikes se Shqiperise.

Cileve qytetare u krijohen, nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, favorizime ne kushtet per fitimin e shtetesisë shqiptare me natyralizim ?

Legjislacioni shqiptar ne fuqi u krijon lehtesira ne kushtet per fitimin e shtetesisë shqiptare me natyralizim te qytetareve te huaj qe :

1. Republika e Shqiperise ka per ta interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombetar;
2. jane persona pa shtetesi;
3. jane me origjine shqiptare (deri ne dy shkalle, qofte edhe nga njeri prind);
4. jane te martuar me nje shtetas shqiptar prej jo me pak se 3 vjetesh.

Cilat jane lehtesirat, qe u jepen te huajve te favorizuar, ne kushtet per fitimin e shtetesisë shqiptare me natyralizim ?

I huaji, per te cilin **Republika e Shqiperise ka interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombetar**, qe ka mbushur moshen 18 vjeç, mund te fitoje shtetesine shqiptare vetem me kushtin qe *dhenia e shtetesisë shqiptare te mos preke sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqiperise.*

Personi pa shtetesi mund te fitoje shtetesine shqiptare kur ploteson kushtet vijuese:

- *Te kete banuar ligjerisht ne territorin e Republikës së Shqiperise, ne menyre te vazhdueshme, per jo me pak se 5 vjet.*
- *Dhenia e shtetesisë shqiptare te mos preke sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqiperise.*

Ne se i huaji verteton se **eshte me origjine shqiptare** deri ne dy shkalle, qofte edhe nga njeri prind, *koha e qendrimit ne Republiken e Shqiperise duhet te jete te pakten deri ne 3 vjet.*

I huaji i **martuar me nje shtetas shqiptar prej jo me pak se 3 vjetesh** mund te kerkoje te marre shtetesine shqiptare, ne rast se ka banuar ne menyre te vazhdueshme dhe te ligjeshme ne Republiken e Shqiperise, te pakten nje vit dhe kur ploteson kushtet vijuese:

- *Te kete mbushur moshen 18 vjeç. Llogaritja behet ne ditën e berjes se kerkeses;*
- *Te kete banese dhe te disponoje te ardhura te mjaftueshme.*
- *Te mos kete gene ndonjehere i denuar (ne Republiken e Shqiperise ose ne ndonje*

vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon denime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie. Përfshirë nga ky rregull behen në rastet kur vlerësohet se denimi është dhënë për motive politike.

- *Dhënia e shtetësisë shqiptare të mos preke sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë.*

Cilat janë dokumentet që i huaji duhet të depozitojë për fitim të shtetësisë shqiptare me natyralizim ?

Shtetasi i huaj për fitim të shtetësisë shqiptare me natyralizim depoziton :

- *Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës. Kërkesa të përmbajë identitetin e plotë të kerkuesit (emër mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit të tij të përhershëm dhe adresën ku pret informim për ecuninë e aplikimit të tij, arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet me emër mbiemër e firmë nga kerkuesi;*
- *Mendimi me shkrim të nëpunës të pranor dokumentet për nivelin e njohurive të gjuhës shqipe;*
- *Çertifikata e lindjes;*
- *Lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësi (fotokopje e noteruar), nëse banon në Shqipëri;*
- *Akti i pronësisë së banesës ose kontratë e zënies me qera të banesës (fotokopje e noteruar);*
- *Kontratë pune për të punësuarit ose vertetim nga Zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët (fotokopje e noteruar);*
- *Dokumente që vertetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë si garanci bankare, libere kursimi, vertetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noteruar);*
- *Dëshmi penaliteti të marrë në vendin e origjinës dhe në vendin ku kerkuesi ka patur qëndrim legal për gjashtë muajt e fundit;*
- *Dokument që verteton qenien azilant, nëse është i tillë (fotokopje e noteruar);*
- *Fotografi e aplikantit, cope tre (Në rast se ka femijë nën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).*
- *Çertifikatë (kur është e nevojshme) për të vertetuar origjinën shqiptare të kerkuesit, deri në dy shkallë, qofte dhe nga njëri prind.*

Cilat jane dokumentet qe nje ish-shtetas shqiptar duhet te paraqese per rifitim te shtetesisë shqiptare ?

Ish-shtetas shqiptar, qe nuk ka fituar shtetesi tjeter, per rifitim te shtetesisë shqiptare depoziton :

- Kerkesa e qytetarit drejtuar Presidentit te Republikes. *Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer, datelindje, vendlindje), numrin dhe daten e dekretit te Presidentit te Republikes nepermjet te cilit i eshte hequr shtetesia shqiptare, adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershëm dhe adresen (nr.telefoni) ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per rifitimin e shtetesisë shqiptare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;*
- Çertifikate lindje dhe familjare;
- Relacion spjegues dhe konfirmimi nga **komisariati i policisë vendore** dhe **prefektura perkatese** lidhur me shtetesine qe kane ose kane patur prinderit e çdo aplikanti;
- Deklarate noteriale nga çdo aplikant mbi 14 vjeç per faktin e aplikimit ose jo per te fituar shtetesi tjeter;
- Vertetimin e njesise administrative perkatese per çdo aplikant mbi 14 vjeç;
- Çertifikaten e lindjes ose te vdekjes te prinderve te çdo aplikanti;
- Fotografi e aplikantit, cope tre (*Ne rast se ka femije nen 14 vjeç, fotografi per secilin prej tyre*).

Cilat jane dokumentet qe shtetasi shqiptar duhet te paraqese per heqje dore nga shtetesia shqiptare ?

Shtetasi shqiptar per heqje dore nga shtetesia shqiptare depoziton :

- Kerkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit te Republikes. *Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer, datelindje, vendlindje, kombesine), adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershëm, si dhe adresen (nr.telefoni) ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per heqjen dore nga shtetesia shqiptare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;*
- Premtimi nga autoriteti kompetent i shtetesisë tjeter ose dokument shtetesisë origjinal, marre ne vendin perkates;

- Çertifikata e lindjes me fotografi e aplikuesit *;
- Çertifikata familjare e aplikuesit *;
- Vertetimi i gjendjes gjyqesore *;
- Vertetimi nga Gjykata e rrethit *;
- Vertetimi nga Prokuroia *;
- Vertetimi nga Zyra e Permbarimit *;
- Vertetimi nga Kryetari i Njesise administrative qe eshte banor i asaj njesie, ne te cilin te konfirmohet adresa e sakte *;
- Çertifikata e martesës se aplikantit e marre ne vendin ku eshte lidhur martesa;
- Dokumenti qe verteton rezidencen, vendbanimin e tij ne shtetin premtues te shtetesisë tjetër. Ne çdo rast ky dokument duhet te jete per te gjithë antaret e familjes;
- Deklarata noteriale e te dy prindërve, ku te shprehet pelqimi i tyre per heqjen dore nga shtetesia shqiptare e femijeve te tyre te moshës deri 18 vjeç;

Dokumentet, te cilat kane shenjen "" te merren ne Republiken e Shqiperise.*

A mund te ftoje shtetesine shqiptare nje femije i lindur ne territorin e Republikës se Shqiperise nga dy prinder te huaj me qendrim te ligjshem ne Republiken e Shqiperise ?

Cilat jane dokumentet qe depozitohen per keto raste ?

Nje femije e lindur ne territorin e Republikës se Shqiperise, nga prinder me shtetesi tjetër, te cilet jane rezidente te ligjshem ne Republiken e Shqiperise, ***mund te marre shtetesine shqiptare me pelqimin e te dy prindërve.***

Prinderit e femijes duhet te depozitojne :

- Kerkesa e prindërve drejtuar Presidentit te Republikës. *Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesve (emer mbiemer, datelindje, vendlindje, shtetesine), adresen e sakte te vendbanimit te tyre te perhershëm dhe adresen (nr.telefoni) ku presin informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per fitimin e shtetesisë shqiptare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesit;*
- Çertifikata e lindjes se femijes;
- Fotografi e femijes, cope tre;

- Çertifikata e cila percakton shtetësinë e të dy prindërve;
- Deklarata noteriale e dy prindërve, ku të shprehet pelqimi i tyre për dhënie të shtetësisë shqiptare fëmijës.

Cilat janë afatet procedurale për shtetësinë shqiptare ?

Ministria e Rendit Publik brenda **6 muajve** nga data e paraqitjes së kërkesës për shtetësinë shqiptare vendos për **paraqitjen ose jo** të kërkesës pranë Presidentit të Republikës.

Vendimi i Ministrisë së Rendit Publik për paraqitjen ose jo të kërkesës pranë Presidentit të Republikës i bëhet i njohur të interesuarve, të cilët nëse nuk janë dakord me përmirësimin e vendimit mund të ngrenë padi në gjykatën e rrethit Tiranë.

Presidenti i Republikës, brenda **3 muajve** nga paraqitja e kërkesës së Ministrisë së Rendit Publik, nxjerr dekretin përkates.

Ku depozitohet dhe nga kush depozitohet kërkesa për shtetësinë shqiptare ?

Kërkesa për shtetësinë shqiptare depozitohet në:

- në komisariat të policisë vendore ku aplikuesi është me banim të përkohshëm ose ka të regjistruar gjendjen civile.
- **edhe** në përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin ku kerkuesi për shtetësinë shqiptare është rezident ose në përfaqësinë që mbulon shërbimet konsullore për vendin ku ai është rezident, **për shtetasit e huaj apo shqiptarë, që banojnë jashtë shtetit**.

Kërkesa për shtetësinë shqiptare depozitohet nga :

- kerkuesi për shtetësinë shqiptare drejtperdrejt;
- përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme (*Nuk praktikohet për rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare me natyralizim*).

Nuk ka asnjë pengesë ligjore që një shtetas shqiptar me rezidence në një vend të huaj të dorëzojë kërkesën për shtetësinë shqiptare në komisariat të policisë vendore ku ka të regjistruar gjendjen e tij civile, nëse qoftë dhe rastesisht gjendet fizikisht në Republikën e Shqipërisë.

Cili është detyrimi i komisaritit të policisë ose i përfaqësuesit diplomatik apo konsullor për të njoftuar depozituesin e dokumenteve për shtetësinë shqiptare ?

Komisariati i policisë ose përfaqësia diplomatike apo konsullor informojnë depozituesin e dokumenteve për shtetësinë shqiptare në:

1. momentin e pranimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës. Nëse dokumentacioni është i rregullt dhe i plotë, depozituesit i leshohet vërtetimi zyrtar.
2. pas marrjes së vendimit të Ministrit të Rendit Publik per paraqitjen ose jo te kërkeses së aplikantit për shtetësinë pranë Presidentit të Republikës. Për vendimin informohet zyrtarisht në adresën e treguar kerkuesi për shtetësinë shqiptare.

Informacioni jepet në adresën e përcaktuar nga i interesuari në kërkesën e tij.

Forma dhe përmbajtja e vërtetimit zyrtar, i cili i jepet aplikuesit për depozitimin e dokumenteve për shtetësinë shqiptare:

a) Për fitim të shtetësisë shqiptare

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Rendit Publik
Drejtoria e Policisë Qarkut
Komisariati i Policisë
 Nr. _____ Regjistrat _____, më _____.200__

V e r t e t i m

U dorëzuan në Komisaratin e Policisë **Per fitimin e shtetësisë shqiptare** aktet vijuese :

1. Kërkesa e shtetësit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës.
2. Çertifikata e lindjes;
3. Lejeqendrimi në Republikën e Shqipërisë sipas kritereve të ligjit "Për shtetësinë shqiptare";
4. Akti i pronësive së banesës ose kontrata e zënies me qera të banesës;
5. Kontrate pune për të punësuarit ose vërtetim nga Zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët;
6. Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve të mjaftueshme për jetesë si qaranci bankare, libereze

- kursimi, vertetime zyrtare te ardhurash;*
 7. *Deshmi penaliteti;*
 8. *Dokument qe verteton qenien azilant;*
 9. *Fotografi me permasa 4x5 cm , cope tre.*
 10. *Çertifikate per te vertetuar origjinen shqiptare te kerkuesit;*
 11. *Faturat e pageses per sherbimin dhe per pagesat per legalizimet perkatese.*

Nepunesi

 (Detyra, emer dhe mbiemer)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Puneve te Jashtme
Perfaqesia Diplomatike

Nr. _____ Regjistrat _____, më _____.200__

V e r t e t i m

*U dorëzuan në Perfaqesine diplomatike (konsullore) **Per fitimin e shtetesisë shqiptare** aktet vijuese :*

1. *Kerkesa e shtetasit te huaj drejtuar Presidentit te Republikës.*
2. *Çertifikata e lindjes;*
3. *Lejeqendrimi ne Republiken e Shqiperise sipas kriterëve te ligjit "Per shtetesisine shqiptare;*
4. *Akti i pronesise se baneses ose kontrata e zenies me qera te baneses;*
5. *Kontrate pune per te punesuarit ose vertetim nga Zyra e tatimeve per te vetpunesuarit ose investitoret;*
6. *Dokumente qe vertetojne disponimin e mjeteve te mjaftueshme per jetese si garanci bankare, librezë kursimi, vertetime zyrtare te ardhurash;*
7. *Deshmi penaliteti;*
8. *Dokument qe verteton qenien azilant;*
9. *Fotografi me permasa 4x5 cm , cope tre.*
10. *Çertifikate per te vertetuar origjinen shqiptare te kerkuesit;*
11. *Faturat e pageses per sherbimin dhe per pagesat per legalizimet perkatese.*

Nepunesi

 (Detyra, emer dhe mbiemer)

b) Per rifitim te shtetesise shqiptare

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Rendit Publik
Drejtoria e Policise Qarkut
Komisariati i Policise

Nr. _____ Regjistrat _____, më _____.200__

V e r t e t i m

U dorëzuan në Komisaratin e Policise **Per rifitimin e shtetesise shqiptare** aktet vijuese :

1. Kërkesa e plote e shtetasit te huaj drejtuar Presidentit te Republikes;
2. Dokument qe verteton refuzimin e shtetesise;
3. Çertifikate lindje dhe familjare ;
4. Deklarate noteriale per faktin e aplikimit ose jo per te fituar shtetesi tjetër;
5. Vertetimin e njesise administrative perkatese;
6. Çertifikaten e lindjes ose te vdekjes se prinderve;
7. Fotografi me permasa 4x5 cm , cope tre.
8. Faturat e pageses per sherbimin dhe pageses per legalizimet perkatese.

N e p u n e s i

 (Detyra, emer dhe mbiemer)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Puneve te Jashtme
Perfaqesia Diplomatike

Nr. _____ Regjistrat _____, më _____.200__

V e r t e t i m

U dorëzuan në Perfaqesine diplomatike (konsullore) **Per rifitimin e shtetesise shqiptare** aktet vijuese :

1. Kërkesa e plote e shtetasit te huaj drejtuar Presidentit te Republikes;
2. Dokument qe verteton refuzimin e shtetesise;
3. Çertifikate lindje dhe familjare ;

4. Deklarate noteriale per faktin e aplikimit ose jo per te fituar shtetesi tjeter;
5. Vertetimin e njesise administrative perkatese;
6. Çertifikaten e lindjes ose te vdekjes se prinderve;
7. Fotografi me permasa 4x5 cm , cope tre.
8. Faturat e pageses per sherbimin dhe pageses per legalizimet perkatese.

N e p u n e s i

(Detyra, emer dhe mbiemer)

c) Per heqje dore nga shtetesia shqiptare

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Rendit Publik
Drejtoria e Policise Qarkut
Komisariati i Policise
 Nr. _____ Regjistrit _____, më _____.200__

V e r t e t i m

U dorëzuan në Komisaratin e Policise **Per heqjen dore nga shtetesia shqiptare** aktet vijuese :

1. Kërkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit te Republikes;
2. Premtimi nga autoritetet kompetente i shtetesisë tjetër ose dokument shtetesisë origjinal;
3. Çertifikate lindje shqiptare;
4. Çertifikate familjare shqiptare;
5. Vertetimi i gjendjes gjyqesore, e marre ne Shqiperi;
6. Vertetim nga Gjykata e rrethit;
7. Vertetim nga Prokuroia
8. Vertetim nga Zyra e Permbarimit
9. Vertetim nga Kryetari i Njesise administrative;
10. Çertifikate martese e aplikantit;
11. Dokument qe verteton rezidencen ne shtetin premtues;
12. Deklarate noteriale e prinderve per pelqimin e tyre per femijet e moshes 14-18 vjeç;
13. Faturat e pageses per sherbimin dhe pageses per legalizimet perkatese.

N e p u n e s i

(Detyra, emer dhe mbiemer)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Puneve te Jashtme
Perfaqesia Diplomatike
Nr. _____ Regjistrat _____, më _____.200__

V e r t e t i m

U dorëzuan në Perfaqesine diplomatike (konsullore) Per heqjen dore nga shtetesia shqiptare aktet vijuese :

1. Kërkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit te Republikës;
2. Premtimi nga autoritetet kompetente i shtetësisë tjetër ose dokument shtetësie origjinal;
3. Çertifikate lindje shqiptare;
4. Çertifikate familjare shqiptare;
5. Vertetimi i gjendjes gjyqësore, e marre ne Shqiperi;
6. Vertetim nga Gjykata e rrethit;
7. Vertetim nga Prokuroia
8. Vertetim nga Zyra e Permbarimit
9. Vertetim nga Kryetari i Njesise administrative;
10. Çertifikate martese e aplikantit;
11. Dokument qe verteton rezidencen ne shtetin premtues;
12. Deklarate noteriale e prinderve per pelqimin e tyre per femijet e moshes 14-18 vjeç;
13. Faturat e pageses per sherbimin dhe pageses per legalizimet perkatese.

N e p u n e s i

(Detyra, emer dhe mbiemer)

Perditesuar me daten 08.09.2003

* * *

Pjese nga ligji nr. 8389, date 05.08.1998 “Per shtetesine shqiptare”
 (Perditesuar me ligjin nr. 8442, date 21.01.1999 “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 8389, date
 05.08.1998 “Per shtetesine shqiptare”)

Neni 4

Askujt nuk mund t'i hiqet shtetesia shqiptare arbitrarisht.

Çdo shtetas shqiptar ka te drejte te heqe dore nga shtetesia shqiptare me kusht me kusht qe te kete qe kete nje shtetesi tjetër; te kete fituar nje shtetesi tjetër apo t'i jete garantuar nga organet kompetente te shtetit te huaj dhenia e nje shtetësie tjetër.

Neni 5

Fitimi dhe rifitimi i shtetësisë shqiptare, si dhe heqja dore prej saj, nga te miturit behet me miratimin e prindërve. Çdo ndryshim ne shtetësinë e te miturve, te moshes 14-18 vjeç, behet duke marre edhe pelqimin e femijes.

Neni 6

Shtetesia shqiptare fitohet me :

- a) lindje;
- b) me natyralizim;
- c) me biresim.

Neni 7

*(I ndryshuar me ligjin nr. 8442, date 21.01.1999 “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 8389, date
 05.08.1998 “Per shtetesine shqiptare”)*

Kushdo qe lind duke pasur qofte edhe njerin prej prindërve me shtetesi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare.

Neni 8

1. Femija e lindur ose e gjetur ne territorin e Republikes se Shqiperise merr shtetësinë shqiptare kur prinderit jane te panjohur dhe per pasoje femija mbetet pa shtetesi.

Ne rast se prinderit e femijes behen te njohur perpara se femija te kete arritur moshen 14 vjeç, dhe ata jane me shtetesi te huaj, shtetesia shqiptare mund te hiqet me kerkese te prindërve te njohur ligjerisht, me kusht qe femija te mos mbetet pa shtetesi.

2. Nje femije e lindur ne territorin e Republikes se Shqiperise, nga prinder me shtetesi tjetër, qe jane rezidente te ligjshem ne Republiken e Shqiperise, mund te marre shtetësinë shqiptare me pelqimin e te dy prindërve.

Neni 9

Marrja e shtetësisë me natyralizim

Nje i huaj qe ka paraqitur kerkese per marrjen e shtetësisë shqiptare me natyralizim e

fiton ate ne raste se ploteson kushtet e meposhtme:

1. Te kete mbushur moshen 18 vjeç.
2. Te kete banuar ligjerisht ne territorin e Republikes se Shqiperise, ne menyre te vazhdueshme ,per jo me pak se 5 vjet.
3. Te kete banese dhe te disponoje te ardhura te mjaftueshme.
4. Te mos kete qene ndonjehere i denuar ne shtetin e vet apo ne Republiken e Shqiperise ose ne ndonje shtet te trete per vepra penale,per te cilat ligji parashikon denime me jo me pak se 3 vjet heqje lirie. Perjashtim nga ky rregull behen ne rastet kur vleresohet se denimi eshte dhene per motive politike.
5. Te kete njohuri ,te pakten fillestare,te gjuhes shqipe.
6. Pranimi i tij si shtetas shqiptar te mos preke sigurimin dhe mbrojtjen e Republikes se Shqiperise;
7. Te huajit, qe ka mbushur moshen 18 vjeç, mund t'i jepet shtetesia shqiptare me natyralizim edhe ne qofte se nuk i ploteson kushtet e ketij ligji, me perjashtim te pikes 6, ne qofte se Republika e Shqiperise ka nje interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombetar.

Ne rast se personi eshte pa shtetesi, kushtet e pikes 1, 3, 4 dhe 5 te ketij neni nuk merren parasysh.

Ne rast se i huaji verteton se eshte me origjine shqiptare deri ne dy shkalle, qofte edhe nga njeri prind, koha e qendrimit ne Republiken e Shqiperise, e permendur ne piken 2 te ketij neni, duhet te jete te pakten deri ne 3 vjet. Te gjitha kushtet e tjera per fitimin e shtetesisë shqiptare te treguara ne kete nen , mebeten te paprekura.

Neni 10

I huaji i martuar me nje shtetase shqiptare prej jo me pak se 3 vjetesh, ne rast se deshiron, mund te fitoje shtetesine shqiptare me natyralizim edhe kur nuk i ploteson kushtet e nenit 9, pikat 2 dhe 5. Ne kete rast i huaji duhet te kete banuar, ne menyre te vazhdueshme dhe te ligjeshme, ne Republiken e Shqiperise te pakten nje vit.

Neni 11

Ne rast se dy prinderit fitojne shtetesine shqiptare me natyralizim, femija e tyre, nen moshen 18 vjeç, kur jeton me prinderit, behet gjithashtu shtetas shqiptar me kerkesen e prinderve dhe pelqimin e femijes, ne qofte se ky eshte ne moshen 14-18 vjeç.

Ne se njeri prej prinderve fiton shtetesine shqiptare, femija e tij nen moshen 18 vjeç behet shtetas shqiptar,ne se kjo kerkohet nga te dy prinderit ose nga njeri prej prinderve kur prindi tjetër eshte pa shtetesi dhe femija ka vendbanimin ne Republiken e Shqiperise.

Neni 12

Ne rast se dy prinder me shtetesi shqiptare biresojne nje te mitur te nje shtetesisë tjetër apo pa shtetesi, femija fiton shtetesine shqiptare.

I mituri i biresuar e fiton shtetesine shqiptare edhe kur njeri prej prinderve eshte shqiptar dhe te dy prinderit, ne çastin e biresimit banojne ne territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe ne çdo rast tjetër kur femija rrezikon te mebtet pa shtetesi,si rezultat i biresimit.

Neni 14

Person, i cili ka hequr dore nga shtetësia shqiptare për shkak të premtimit për fitimin e një shtetësie tjetër, e rifiton shtetësinë shqiptare në qoftë se nuk fiton shtetësinë e premtuar brenda një kohe të arsyeshme.

Edhe në këtë rast bëhet një kërkesë dhe paraqiten dokumentet e nevojshme.

Mbarimi i shtetësisë shqiptare :

Neni 15

Shtetësia shqiptare merr fund me kërkesë të personit, kur ai plotëson kushtet e mëposhtme

1. Ka mbushur moshën 18 vjeç;
2. Nuk mbetet pa shtetësi si rezultat i heqjes dore nga shtetësia shqiptare meqenëse ka shtetësi të huaj, fiton shtetësi të huaj ose garanton se do të fitojë shtetësi të huaj.
3. Është rezident në një shtet të huaj;
4. Nuk është në ndjekje penale për vepra penale, për të cilat, sipas legjislacionit shqiptar, parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 vjet;
5. Nuk ka detyrime ligjore ndaj autoriteteve shtetërore, personave juridike dhe fizike.

Neni 16

(I ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.01.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare")

Për të miturit shtetësia shqiptare mund të mbarojë kur të paktën njëri nga prinderit ka hequr dore nga shtetësia shqiptare. Në këtë rast kërkohej pëlqimi i të dy prindërve.

Edhe kur njëri prej prindërve nuk është dakort që fëmija të humbasë shtetësinë shqiptare, fëmijës mund t'i hiqet shtetësia, nëse çmohet se një gjë e tillë është në dobi të fëmijës dhe nëse fëmija ka apo do të marrë një shtetësi tjetër.

Fëmija i mitur e humbet shtetësinë shqiptare kur biroshehet nga prinder të huaj dhe fiton, në këtë rast, një shtetësi të re.

Procedura ligjore për shtetësinë shqiptare

Neni 19

Ministria e Rendit Publik brenda 6 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës së individit, në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare, vendos për paraqitjen ose jo të kërkesës të kërkesës për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës.

Kërkesa e Ministrisë së Rendit Publik shoqërohet me dosjen e plote individuale të kërkuarit.

Vendimi për berjen ose jo të kërkesës nga ana e Ministrisë së Rendit Publik i bëhet i njohur subjekteve të interesuara, të cilët, nëse nuk janë dakort me përmbytjen e tij, mund të ngrenë padi në gjykatën e rrethit Tiranë.

Neni 20

Presidenti i Republikës, brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës së Ministrisë së Rendit Publik, nxjerr dekretin përkatës.

Kur janë kushtet e pikës 7 të nenit 9 të këtij ligji, dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nxirret edhe pa ndjekur procedurën e mesipërme.

Neni 21

Kopje e dekretit për fitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare u dërgohet Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Drejtësisë për të bërë veprimet e duhura. Dekreti botohet edhe në fletorën zyrtare.

Neni 23

Personi që fiton shtetësinë shqiptare me matyralizim betohet para nepunësit të zyrës së regjistrimit të shtetasve për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektim të Kushtetutës e të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Shtetësia shqiptare quhet efektivisht e fituar që nga dita e berjes së betimit.

Neni 27

Shteti shqiptar ruan të drejtën që, në përputhje me frymën e konventave ndërkombëtare për menjanimin e rasteve të dyshtetësisë dhe të pashtetësisë, t'i kërkojë shtetasit të vet ose kerkuesit të shtetësisë shqiptare të zgjedhë vetëm një shtetësi..

*

*

*

Pjesë nga udhëzimet “Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dore nga shtetësia shqiptare”

Vendi i aplikimit për shtetësinë shqiptare:

Aplikimi për shtetësinë shqiptare është individual, veç të miturve deri në moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prinderit e tyre.

Aplikimi nga shtetas të huaj ose shqiptarë për fitim, rifitim ose heqje dore nga shtetësia shqiptare bëhet :

- në komisarjat të policisë vendore ku aplikuesi është me banim të perkohshëm ose ka

te regjistruar gjendjen civile.

- per shtetasit e huaj, apo shqiptare, qe banojne jashte shtetit aplikimi mund te behet edhe ne përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin ku ai është rezident ose në përfaqësinë që mbulon shërbimet konsullore për vendin ku ai është rezident.

Ne komisariatit e policise vendore ose ne perfaqesine i perfaqesine diplomatike apo konsullore, i ngarkuar ne detyre pret aplikantet per fitim, rifitim ose heqje dore nga shtetesia shqiptare, u kontrollon atyre dokumentet perkatese dhe kur i gjen ato te plota e te rregullta ben pranimin e tyre kundrejt pageses ne arke.

Per sherbimet qe do te kryhen per shtetesine, nga aplikuesi behet pagese me mandatarketimi ne arken e komisariatit ne vleren 5.000 Leke (30 dollare USA, ne perfaqesine diplomatike apo konsullore). Ne kete vlefte perfshihet edhe TVSH-ja. Pagesa behet kur dorezohen dokumentet dhe eshte e pakthyeshme.

Punonjesi i policise se shtetit, si dhe ai i perfaqesise diplomatike-konsullore mban pergjegjesi per saktesine dhe rregullsine e dokumenteve qe u pranon aplikanteve. Per depozitim e dokumenteve aplikanteve u leshohet vertetimi zyrtar, sipas qellimit te aplikimit

Dokumente, qe kerkohen per shtetesine shqiptare:

a) Per fitimin e shtetesisë :

- Me lindje :

Per femije te lindur ne territorin e Republikes se Shqiperise nga prinder me shtetesi te huaj, por qe te dy jane rezidente te ligjshem ne Republiken e Shqiperise :

- Kerkesa e prinderve drejtuar Presidentit te Republikes. *Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesve (emer mbiemer, datelindje, vendlindje, shtetesine), adresen e sakte te vendbanimit te tyre te perhershëm dhe adresen (nr.telefoni) ku presin informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per fitimin e shtetesisë shqiptare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesit;*
- Çertifikata e lindjes se femijes;
- Fotografi e femijes, cope tre.
- Çertifikata e cila percakton shtetesine e te dy prinderve;
- Deklarata noteriale e dy prinderve, ku te shprehet pelqimi i tyre per dhenien e shtetesisë shqiptare femijes.

- Me natyralizim :

- Kerkesa e shtetasit te huaj drejtuar Presidentit te Republikes. *Kerkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer, datelindje, vendlindje, shtetesine), adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershëm dhe adresen ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per fitimin e shtetesisë shqiptare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;*
- Mendimi me shkrim te nepunesit qe pranon dokumentet per nivelin e njohurive te

gjuhes shqipe;

- Çertifikata e lindjes;
- Lejeqendrimi ne Repuliken e Shqiperise, sipas kritereve te ligjit per shtetesine (fotokopje e noteruar), ne se banon ne Shqiperi;
- Akti i pronesis se baneses ose kontrata e zenies me qera te baneses (fotokopje e noteruar);
- Kontrate pune per te punesuarit ose vertetim nga Zyra e tatimeve per te vetpunesuarit ose investitoret (fotokopje e noteruar);
- Dokumente qe vertetojne disponimin e mjeteve financiare te mjaftueshme per jetese si garanci bankare, libreze kursimi, vertetime zyrtare te ardhurash (fotokopje e noteruar);
- Dëshmi penaliteti e marre ne vendin e origjines dhe ne vendin ku kerkuesi ka patur qendrim legal per gjashte muajt e fundit;
- Dokument qe verteton qenien azilant, nese eshte i tille (Fotokopje e noteruar);
- Fotografi e aplikantit, cope tre (Ne rast se ka femije nen 14 vjeç, fotografi per secilin prej tyre).
- Çertifikate (kur eshte e nevojshme) per te vertetuar origjinen shqiptare te kerkuesit, deri ne dy shkalle, qofte dhe nga njeri prind.

b) Per rifitimin e shtetesisë shqiptare :

Personi qe ka hequr dore nga shtetesia shqiptare per shkak te premtimit per fitimin e nje shtetesisë tjetër, e rifiton shtetesisë shqiptare ne qofte se nuk ka fituar shtetesisë e premtuar. Ne keto raste paraqiten dokumentet vijuese:

- Kërkesa e qytetarit drejtuar Presidentit te Republikës. *Kërkesa te permbaje identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer, datelindje, vendlindje), numrin dhe daten e dekretit te Presidentit te Republikës nepermjet te cilit i eshte hequr shtetesia shqiptare, adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershëm dhe adresen (nr.telefoni) ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per rifitimin e shtetesisë shqiptare. Kërkesa nenshkruhet në emer mbiemer e firme nga kerkuesi;*
- Çertifikate lindje dhe familjare;
- Relacion spjegues dhe konfirmimi nga komisarati i policisë vendore dhe prefektura perkatese lidhur me shtetesisë qe kane ose kane patur prinderit e çdo aplikanti;
- Deklarate noteriale nga çdo aplikant mbi 14 vjeç per faktin e aplikimit ose jo per te fituar shtetesi tjetër;
- Vertetimin e njesise administrative perkatese per çdo aplikant mbi 14 vjeç;
- Çertifikaten e lindjes ose te vdekjes te prinderve te çdo aplikanti;
- Fotografi e aplikantit, cope tre (Ne rast se ka femije nen 14 vjeç, fotografi per secilin prej tyre).

c) Per heqjen dore nga shtetesia :

- Kërkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit te Republikës. *Kërkesa te permbaje*

identitetin e plote te kerkuesit (emer mbiemer, datelindje, vendlindje, kombesine), adresen e sakte te vendbanimit te tij te perhershëm, si dhe adresen (nr.telefoni) ku pret informim per ecurine e aplikimit te tij, arsyet e kerkeses per heqjen dore nga shtetsia shqiptare. Kerkesa nenshkruhet me emer mbiemer e firme nga kerkuesi;

- Premtimi nga autoriteti kompetent i shtetesise tjeter ose dokument shtetesie original, marre ne vendin perkates;
- Çertifikata e lindjes me fotografi e aplikuesit *;
- Çertifikata familjare e aplikuesit *;
- Vertetimi i gjendjes gjyqesore *;
- Vertetimi nga Gjykata e rrethit *;
- Vertetimi nga Prokuroia *;
- Vertetimi nga Zyra e Permbarimit *;
- Vertetimi nga Kryetari i Njesise administrative qe eshte banor i asaj njesie, ne te cilin te konfirmohet adresa e sakte *;
- Çertifikata e martesese se aplikantit e marre ne vendin ku eshte lidhur martesa;
- Dokumenti qe verteton rezidencen, vendbanimin e tij ne shtetin premtues te shtetesise tjeter. Ne çdo rast ky dokument duhet te jete per te gjithë antaret e familjes;
- Deklarata noteriale e te dy prinderve, ku te shprehet pelqimi i tyre per heqjen dore nga shtetsia shqiptare e femijeve te tyre te moshes deri 18 vjeç;

Dokumentet, te cilat kane shenjen "" te merren ne Republiken e Shqiperise.*

Fotografia te jete ne permasat 4x5 cm, e bere ne planin ballor, me balle te hapur, pamja deri ne mjekër te mbuloje 70 perqind te saj.

Te gjithë dokumentet per shtetesine shqiptare (te prodhuara ne Shqiperi, apo ne vende te tjera) pranohen kur jane ***ne harmoni te plote me njeri tjetrin, pa gabime e pa korigjime.***

Dokumentet pranohen kur jane origjinale (perveç atyre qe jane percaktuar fotokopje), te legalizuara secili me vete ne perfaqesine tone diplomatike apo konsullore ne vendin ku ato jane leshuar, te shqiperuara e noteruara.

Data e leshmit te tyre te mos kapexejë gjashte muajt e fundit, ndersa premtimi, ose dokumenti i shtetesise tjeter, jo me shume se dy vitet e fundit.

Afatet e vlefshmerise llogariten mbi bazen e dates se pranimi te dokumenteve nga komisarati i policise vendore ose perfaqesia diplomatike a konsullore.

Ministri i Rendit Publik mer vendim per paraqitjen ose jo te kerkeses se aplikantit per shtetesine prane Presidentit te Republikes per te gjithë aplikuesit e moshes mbi 14 vjeç. Vendimi i behet i njohur zyrtarisht Ministrise se Puneve te Jashtme dhe drejtorise se policise qarkut perkates, te cilet nga ana e tyre informojne zyrtarisht te interesuarin ne adresen qe ai ka caktuar per kete qellim.

Perditesuar me date 08.09.2003

* * *